

**UDHËZIM**  
**Nr.29, datë 25.8.2005**

**PËR NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR.5, DATË 5.4.2005, I NDRYSHUAR, “PËR  
DETYRAT E POLICISË SË SHTETIT DHE FORCAVE TË ARMATOSURA PËR  
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË VITIT 2005”**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 25.8.2005 në mbështetje të nenit 29 pika 1, nenit 104, 105 pika 2, nenit 116, nenit 109/1, pika 2 dhe 3 të ligjit nr.9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë“, i ndryshuar, dhe neneve 60/a deri 60/ç të ligjit nr.8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar,

**UDHËZON:**

**Neni 1**

Në udhëzimin nr.5, datë 5.4.2005 “Për detyrat e Policisë së Shtetit dhe Forcave të Armatosura për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2005”, ndryshuar me udhëzimin nr.18, datë 10.6.2005, pas nenit 10, shtohet neni 10/1 me këtë përmbajtje:

“Dispozitat e këtij udhëzimi zbatohen edhe në rastin e zgjedhjeve të pjesshme për Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjeve të pjesshme për organet e qeverisjes vendore.”.

**Neni 2**

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.